



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.994/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Adanov” Sh.P.K., me seli në Maqedoninë e Veriut, të cilin e përfaqëson Ngadhënjim Rudi avokat nga Kaçaniku, kundër debitorit "Uka Saraj" Sh.P.K., me, NUI ..., me seli në Han të Elezit, Rruga "Suad Brava", për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.783/2022, të datës 26.05.2023, me datën 23.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Adanov” Sh.P.K., me seli në Maqedoni e Veriut, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.783/2022, të datës 26.05.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.783/2022, të datës 26.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "Uka Saraj" Sh.P.K., ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.44/2021 të datës 24.02.2021, të Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar dhe të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.783/22 të datës 26.05.2023 si i bazuar dhe jo i ligjshëm, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.44/2021 të dt. 24.02.2021 si i bazuar dhe i ligjshëm.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të

Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "Adanov" Sh.P.K., me seli në Pionerska, ka caktuar urdhrin P.nr.44/21 me datën 24.02.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me numër 18-381-000004 të datës 06.12.2018 dhe faturës me numër 18-382-000009 të datës 26.04.2018, me të cilat e ka urdhëruar debitorin "Uka Saraj" Sh.P.K., që në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura, t'ia paguaj shumën prej 5,067.30 €, me kamatë ligjore, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbartim si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër Urdhrit për Lejimin e Përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim. Në prapësim debitori ka theksuar se kundërshton në tërësi propozimin për përmbartim, ka theksuar se bazuar në nenin 71 të LPP-së, dokumenti në bazë të urdhrit përmbartues nuk ka tiparet e përmbartueshmërisë si dhe nuk ka efekti të titullit përmbartues sepse nuk paraqet dokument të besueshëm sipas LPP-së, neni 27 lidhur me nenin 29.3, sepse faturat nuk janë të vulosura dhe të nënshkruara nga ana e debitorit. Ka shtuar se me qenë se faturat nuk përmbajnë kushtet e LPP-së dhe faktit se debitori UKA Saraj- pronari N. B. nuk e pranon obligimin si të tijin dhe me anë të provave dëshmon se ky obligim është i D. S. sh.p.k., pronar A. J., me të cilin asetet e biznesit i ka ndarë me marrëveshje noteriale. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor P.nr.44/2021 i datës 24.02.2021, i përmbartuesit privat Sheremet Livoreka.

Duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.783/2022, të datës 26.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "Uka Saraj" Sh.P.K., ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.44/2021 të datës 24.02.2021, të Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dhomat e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, dhe të njëjtat nuk janë nënshkruar nga personi i autorizuar i debitorit, që do të thotë se nuk ka prova se faturat në fjalë i janë dorëzuar ndonjëherë debitorit.

Me Nenin 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) është paraparë që për përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm “është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.” Ndërsa me Nenin 30 të LPP-së parashihet se “kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbartimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin e debitorit me arsyet se urdhri për përmbartim është lejuar mbi bazën e faturave të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por të njëjtat janë fatura nga një vend i huaj dhe faturat e tilla të lëshuara sipas normave juridike të vendit të huaj nuk mund të pranohen si dokumente përmbartimore sipas LPP në Kosovë.

Andaj, Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në tërësi e përkrahin qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret faturat janë të panënshkruara – gjë që nënkupton se në rastin në fjalë nuk ka pasur dorëzim rregullt të faturave nga ana e kreditorit përkatësisht pranim të rregullt të faturave nga ana e debitorit.

Për më tepër Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se në bazë të shkresave të lëndës, shihet qartë se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit mbështetet në fatura të lëshuara në gjuhë dhe nga subjekti juridik i shtetit të huaj, të cilat me faktin se nuk janë pranuar me rregull nga debitori nuk mund të trajtohen si dokumente të besueshme sipas dispozitave të LPP-së.

Së këndejmi, zbatimi i dokumentit të besueshëm të një vendi tjetër nga Republika e Kosovës i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të Nenit 11 të LPP-së sipas të cilit “Përmbartimi i dokumentit të huaj përmbartimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbartimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranim dhe përmbartim.” Në rastin konkret, nga faturat nuk rrjedh nëse në to është treguar se është bërë e kërkueshme kredia, ndërkaq detyrimet i referohen legjislacionit të vendit të huaj të cilat si të tilla nuk mund t’i nënshtrohen aplikimit të dispozitave të vendit.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.994/23, me datë 23.10.2023

Gjyqtari
Dren Rogova